



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M
Nr. 52, date 24.06.2019

**PËR DHËNIEN E TITULLIT VENDOR TË NDERIT
“MIRËNJOHJA E BASHKISË SHKODËR” Z. XHAHID BUSHATI**

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës 24.06.2019, me propozim të Myftinisw Shkodwr, mbështetur në nenin 54 shkronja “m”, neni 55 pika 2, të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenin 15 të ligjit nr. 112/2013 “Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr. 861, datë 10.12.2014 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve këshillimore për dhënie të medaljeve dhe titujve vendore të nderit në Republikën e Shqipërisë”, VKB nr. 61, datë 30.11.2016 “Rregullore për titujt vendorë të nderit në Bashkinë Shkodër, kriteret dhe procedurën e dhënies së tyre“, relacionit datë 11.06.2018 të komisionit këshillimor për titujt vendorë të nderit në Bashkinë Shkodër,

V E N D O S I:

1. Dhënie të titullit vendor të nderit “Mirënjohja e Bashkisë Shkodër” z. **Xhahid Bushati**, me motivacionin:

“Intelektual i shquar, një nga shkrimtarët më të mirë në rang kombëtar i letërsisë për fëmijë, autor i dhjetëra librave; studiues dhe kritik letrar, një ndër zërat më të spikatur të letrave shqipe në rang kombëtar dhe në mbarë trevat shqiptare; i përkushtuar në studimin dhe evidentimin e krijimtarisë dhe vlerave artistike të shkrimtarëve dhe artistëve shkodranë ndër vite”.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet sekretari i këshillit bashkiak.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Miratuar në datën 24.06.2019
Shpallur në datën 24.06.2019

Sekretar i këshillit

K R Y E T A R

Suel Hadri

Xhemal BUSHATI